



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 126

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA
PARTIA “LËVIZJA DEMOKRATIKE SHQIPTARE” PËR ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Partia “Lëvizja Demokratike Shqiptare” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Partia “Lëvizja Demokratike Shqiptare” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmeore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmeore të kandidatëve për deputet të Partisë “Lëvizja Demokratike Shqiptare” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmeore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
2. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12. z. Muhamet Hysen, **Qarku Elbasan**, pika 8 rezultoi e paplotësuar.



3. Në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 4, zj. Megi Hoxha dhe nr. 7 z. Eroid Buzo, **Qarku Korçë**, rubrika II rezultojnë të pa plotësuar emri dhe mbiemri, kandidati me numër rendor 5, z. Genci Jazhi, pika 8 rezulton e pa plotësuar dhe kandidati me numër rendor 10, zj. Rajna Bllazhda Tahiraj, rubrika II rezulton e paplotësuar me emër mbiemër.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor Partisë “Lëvizja Demokratike Shqiptare”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V E N D O S :

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë “Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021..
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

